



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 120, datë 19.05.2022

**“PËR VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZOTIT URIM KALIA,
KANDIDAT PËR MAGJISTRAT PROKUROR, I CILI DO TË DIPLOMOHET NGA
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2022”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit për magjistrat prokuror zotit Urim Kalia, i cili do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2022”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatit për t’u emëruar Prokuror, zotit Urim Kalia, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit Urim Kalia.
3. Lejimin e kandidatit Urim Kalia të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e tij si prokuror.
4. Të njoftohet për këtë vendim zoti Urim Kalia.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot 19.05.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
ALFRED BALLA

ZV/KRYETAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
MIRELA BOGDANI